



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

“Specialist Logjistike dhe data entry”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kondidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Specialist Logjistike dhe data entry**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Specialistit të Logjistikës dhe data entry

Specialisti i Logjistikës është përgjegjës për planifikimin, organizimin, koordinimin e operacioneve logjistike të lidhura me projektin. Ai gjithashtu është përgjegjës për organizimin e transportit të njerëzve, materialeve, mirmbajtjen e mjeteve në përdorim, si dhe monitorimin e efektivitetit dhe kostove të transportit të brendshëm. Ky person do të përfshihet dhe në procesin e hedhjes dhe menaxhimit të të dhënave të projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Specialisti Logjistikës duhet të kryejë detyrat si më poshtë:



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Përgjegjës për ndjekjen e infrastrukturës së zinxhirit të furnizimit me materiale të përdorimit të përditshëm.
- Mbikqyr statusin e dërgesave në shkollat e Tiranës dhe rretheve.
- Zgjidh në mënyrë eficiente dhe sa më praktike emergjencat e lindura.
- Garanton mirëmbajtjen e të gjitha materialeve fizike të projektit dhe pajisjet e tjera.
- Mban nën kontroll objektivat mbi koston, efektivitetin, saktësinë e dërgesave.
- Koordinohet me magazinën.
- Përgjegjës për transportin e njërëzve dhe materialeve, duke koordinuar procesin dhe duke u përfshirë personalisht në proces.
- Do të përfshihet në procesin e hedhjes dhe menaxhimit të dhënave të projektit (data entry).
- Cdo detyrë tjetër logjistike/administrative që bie nën këtë pozicion apo që i ngarkohet nga epërorët.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Shkollë e Mesme ose Diplomë Universitare Bachelor në IT, Administrim Biznes, Logjistikë, etj.
- Preferohet 1 vit eksperiencë në logjistikë dhe/ose menaxhim
- Trajnime në menaxhim ose logjistikë.
- Leje drejtimi kategoria B ose C (preferohet kategoria C)

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe në zgjidhjen e problemeve.
- Aftësi të forta organizative dhe në vendimmarrje.
- Aftësi pune në grup dhe nivel të lartë bashkëpunimi



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Në gjendje të kuptojë llogaritjet financiare dhe menaxhimin e buxheteve.
- Fleksibël, edhe në rastet kur i ngarkohen detyra të tjera.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al , me subjekt: **Aplikim për pozicionin Specialist Logjistike dhe data entry “Ekipet Sportive 2022”**

